



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:280898

Datë: 17.06.2022

Numri i dokumentit: 03146239

**PKR.nr.94/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**-Departamenti për krime të rënda, me Kryetarin e trupit gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fitore Bojku, në çështjen penale ndaj të pandehurve V.Sh.dhe A.H.për shkak se në bashkëveprim kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.1, lidhur me nenin 31, të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.275/21, të dt. 20.05.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me datë 08.06.2022, në prezencë të Prokurorit të shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të pandehurit V.Sh., mbrojtësi i tij av. V.B., sipas detyrës zyrtare, të pandehurit A.H., mbrojtësit të tij av. H. M. sipas autorizimit, në të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me dt.17.06.2022, përpiloi dhe merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

Të pandehurit

**V. SH.**, i biri i .... dhe nënës ...., e gjinisë ..., i lindur me dt. ..., në K. F., me vendbanim L., rr. "....."p.nr, ka të kryer shkollën fillore, identifikuar në bazë të lnj.nr....., i pamartuar, me profesion-fasader, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon nr. tel....., shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, ka qenë në paraburgim nga dt. 13.12.2021, e deri me dt. 10.06.2022, tani mbrohet në liri.

**A.H.**, i biri i .... dhe nënës ...., e gjinisë ... i lindur me dt. ..., në B. L., R.F.Gj., me vendbanim në L., rr. "... " nr. 7, ka të kryer shkollën fillore, identifikuar në bazë të lnj.nr..... i pamartuar, me profesion-punëtor i thjeshtë, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon nr. tel....., shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, ka qenë në paraburgim nga dt. 13.12.2021, e deri me dt. 10.06.2022, tani mbrohet në liri.

**JANË FAJTORË**

**Për shkak se:**

Me dt.13.12.2021, rreth orës 12:30 min, në fsh. Z., K. K., duke vepruar në bashkëkryerje, pa autorizim, e me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes, posedojnë substanca të cilat janë të shpallura me ligj si narkotik, në atë mënyrë që përderisa patrulla e policisë ishin vendosur në një pikë statike pranë rrugës magjistrale P.-P., ndalin veturën e markës O.A, me targa ....., të cilën po e drejtonte i pandehuri V.Sh., e i cili ishte në shoqërimin edhe të të pandehurit A.H., ashtu që policia kërkojnë nga i pandehuri V. prezantimin e dokumentacionit personal dhe të automjetit, por i njëjti u prezanton vetëm librezën e automjetit dhe që të dy shfaqin sjellje të dyshimta, gjë që rezulton me kontrollë fizike të tyre nga ana e policisë, me ç'rast në rroba të brendshme të të pandehurit V. , gjejnë substancë narkotike të llojit marihuanë, në peshë prej 0.5 gr., ndërsa në veturë gjejnë një thikë dhe dy pako rizlle (letra për mbështjellje të marihuanës), e më pastaj të njëjtit i shoqërojnë pranë stacionit policor në K., ku pas kontrollit detal të automjetit, në pjesën e motorit, respektivisht në plastikën e ventilimit, gjejnë të fshehur një pako të mbështjellë me qese plasmasi, me substancë narkotike të llojit marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 474.68 gr.

-me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale blerja posedimi, shpërndarja, dhe shitja e paautorizuar e narkotike, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 7, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 72 par 1 nenpar 1.3 të KPRK-së, nenit 267 par. 1 lidhur më nenin 31 të KPP-së dhe nenin 365 të KPP-së, të pandehurit i:

## **G J Y K O N**

### **Të pandehurin V.SH.**

I. Dënimi me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, të cilin dënim obligohet që ta paguajë me se largu në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit, dhe

II. Dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, te cilin dënim i pandehuri do ta mbajë, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg, ashtu që një ditë burgim llogaritet me 20 euro të gjobës.

### **Të pandehurin A.H.**

I. Dënimi me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, të cilin dënim obligohet që ta paguajë me se largu në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit, dhe

II. Dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, te cilin dënim i pandehuri do ta mbajë, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, ashtu që një ditë burgim llogaritet me 20 euro të gjobës.

-Të pandehurit secili veç e veç obligohen në paguarjen e shpenzimeve procedurale penale, për paushallin gjyqësor shumën prej 100 (njëqind) euro, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurit secili veç e veç obligohen në paguarjen e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Konform nenit 267 par.5 të KPRK-së, KONFISKOHET, substancën narkotike e llojit marihuanë në sasi prej 474.68gr, dhe e njëjta substancë pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi duhet te shkatërrohet.

Konform nenit 115 par 2 nenpar 2.1 dhe 2.2 te KPP-së, nga te pandehurit konfiskohen

Nga i pandehuri V.Sh.të konfiskohen:

Telefonat S.A.A., modeli SM-A105FN me IMEI ..... dhe IMEI2....., të cilët telefona pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi duhet te shkatërrohen.

Vetura e markës O.A, ngjyrë e kaltër, me targa ....., se bashku me librezën e qarkullimit me nr ..... dhe çelësin e veturës, e cila veturë pas plotfuqishmërie se këtij aktgjykimi duhet te shitet, dhe paratë e fituara nga shitja e kësaj veture duhet te derdhën në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Nga i pandehuri A.H.të konfiskohen:

Një telefon I-phone X, ngjyrë e bardhë, me nr. Serik 3....., i cili telefon pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi duhet te shkatërrohet.

Dhe kartëmonedhat: *Një Kartëmonedhë 1 x 50,00 Euro me nr. serik RD0218677917; Një Kartëmonedhë 1 x 50,00 Euro me nr. serik UB.....; Një Kartëmonedhë 1 x 20,00 Euro me nr. serik XA.....; Një Kartëmonedhë 1 x 20,00 Euro me nr. serik SE.....; Një Kartëmonedhë 1 x 10,00 Euro me nr. serik TA.....3; Një Kartëmonedhë 1 x 10,00 Euro me nr. serik YA.....; Një Kartëmonedhë 1 x 10,00 Euro me nr. serik PA.....; një Kartëmonedhë 1 x 5,00 Euro me nr. serik NB.....; 9 x 2,00 Euro, monedha të metalta; 13 x 1,00 Euro, monedha të metalta; 2 x 0,20 Euro cent, monedha të metalta; 2 x 0,10 Euro cent, monedha të metalta; 1 x 0,05 Euro cent, monedha të metalta; Me shumë të përgjithshme:206,65 Euro, e te cilat para pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi duhet te derdhën në buxhetin e Republikës së Kosovës.*

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për krime të rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.275/21, të dt. 20.05.2022, ndaj të pandehurve V.Sh.dhe A.H.për shkak se në bashkëveprim kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar

e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.1, lidhur me nenin 31, të KPRK-së.

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 08.06.2022, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar prezentë kanë qenë Prokurorja e Shtetit Valbona Disha Haxhosaj, i pandehuri V.Sh., mbrojtësi i tij av. V.B., sipas detyrës zyrtare, i pandehuri A. H., mbrojtësi i tij av. H. M., sipas autorizimit.

Gjykata konform dispozitave të nenit 246 par. 1 të KPP-së, i ka udhëzuar të pandehurit me të drejtat e tyre, ku në këtë rast të pandehurit kanë deklaruar se i kanë kuptuar këto të drejta dhe për mbrojtës i pandehuri V.Sh.e ka pranuar av. V.B.j, i caktuar sipas detyrës zyrtare dhe i pandehuri A.H.e ka angazhuar av. H.M. sipas autorizimit në shkresat e lëndës.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurorja e shtetit, kryetari i trupit gjykues, pasi që është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën, iu është dhënë mundësia të pandehurve që të deklarohen për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I pandehuri V. Sh., e ka pranuar fajësinë për veprën penale cila i vihet në barrë, i kërkon falje gjykatës, premtion se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale.

Mbrojtësi i të pandehurit V. Sh., av. V.B., ka deklaruar se e mbështet deklaratën e të mbrojturit të tij për pranimin e fajësisë ngase kjo deklaratë vjen, pasi që të mbrojturi të tij i ka shpjeguar dhe i ka kuptuar pasojat dhe benefitet e institutit të pranimin të fajësisë, i njëjti në mënyrë vullnetare me vetëdije dhe pa asnjë ndikim ka pranuar fajësinë, për çka i propozon gjykatës që të aprovojë pranimin e fajësisë dhe të njëjtën ta vlerësoj si rrethanë posaqërisht lehtësuese, kërkon nga gjykata që gjatë vlerësimit dhe vendosjes mbi dënim të merr parasysh edhe rrethanat tjera lehtësuese siç janë: premtimi se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, gjendja ekonomike, niveli i arsimit, mosha e re dhe ndaj të njëjtit të shqiptoni një dënim sa më të butë, mundësisht të kushtëzuar. E kundërshton propozimin e prokurorisë për konfiskimin e veturës, ngase e njëjta nuk ka ndonjë konstruksion të veçantë për fshehjen dhe bartjen e substancave narkotike dhe se me konfiskimin e saj do të vështirësohej jeta e familjes së të mbrojturit të tij V.. Kërkon nga gjykata që të mbrojturit të tij ti ndërprehet masa e paraburgimit, për shkak se konsideron se kanë pushuar së ekzistuari kushtet për të cilat edhe caktuar paraburgimi.

I pandehuri A. H., e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ndihet fajtor dhe i penduar, i premtion gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale, kërkon nga gjykata që të ketë parasysh gjendjen e vështirë ekonomike në të cilën gjendet.

Mbrojtësi i të pandehurës A.H., av. H. M., e ka deklaruar se, duke u mbështetur në deklarinimin e të mbrojturit të tij, i cili ishte rezultat i konsultimit të mjaftueshëm të mundësuar nga gjykata, pasi që më parë janë sqaruar të kuptuarit e rëndësisë peshës dhe natyrës së veprës penale, me vullnet të shprehur dhe të deklaruar bëri këtë pranim, pa mashtrim, premtim, apo lajthitje faktike juridike, pasi që aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore, apo gabim të gjendjes së fakteve, duke sqaruar ato që më parë e njoftoi gjykata për benefitet ligjore se i përket vendimit mbi dënim, i propozon prokurorit që ta aprovojë këtë pranim dhe e lut gjykatën që ta miratojë një pranim të

tillë, njëherit kërkon nga gjykata sa i përket vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit të merr parasysh vullnetin e pranimit, ndërjegjen, pendimin, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të bie në kundërshtim me ligjin, andaj në kuptim të nenit 38 lidhur me nenin 71 dhe 72 , par.1, nënpar.1.4, të KPP-së, sa i përket zbutjes së dënimit, konform kësaj dispozite ti shqiptojë dënimin ashtu siç e parashih ligji, në situatën më të favorshme, një dënim të kushtëzuar dhe të rishqyrtojë ligjshmërinë e ndryshimit të masës së paraburgimit, qoftë ta heq në tërësi, apo ta zëvendësojë në ndonjërin nga masat deri në plotfuqishmëri në kuptim të nenit 173 të KPP-së, rrethanat lehtësuese të cilat konsideroj se gjykata do ti shqyrtojë, i mbrojturi i tij është i punësuar dhe punon me nënën e tij në mirëmbajtje, pastrimin e një kompanie në qytezën e L. dhe me të ardhurat e tij kontribon në të ardhurat e familjes, relativisht i ri dhe premtimin e tij se në të ardhme nuk do të kryejë vepra tjera penale dhe lut gjykatën që të merr parasysh këto rrethana në kushtin që mos të përsëris dhe duke konsideruar se ia vlen të ipet rasti që gabimin e bërë ta përmirësojë në jetën e tij sepse i ka kuptuar pasojat e kryerjes së veprës penale.

Prokurorja i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve secili veç e veç meqenëse një pranim është i bazuar edhe në provat në bazë të cilave është ngrit aktakuza, andaj i propozon gjykatës që ta aprovojë. Sa i përket marrjes së vendimit mbi dënim përveç rrethanave lehtësuese të cekura nga të dy mbrojtësit, në raport me të pandehurin V. Sh., i propozon gjykatës që ta vlerësoj si rrethanë rënduese faktin se i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar për veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve nga neni 269 të KPRK-së. Ndërsa rrethana tjera rënduese nuk ka gjetur, po ashtu mbetet pranë propozimit për konfiskim të cekur në aktakuzë. Shton se sa i përket cilësimit juridik në dispozitiv të aktakuzës është përvjedh një gabim teknik, ku në vend të nenit 321, duhet të jetë neni 31, (bashkëkryerje). Ndërsa sa i përket masës së paraburgimit, ia lë në vlerësim gjykatës.

Kryetari i trupit gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi që te pandehurit e kuptuan natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: raporti i oficerit R P me nr.....-DHTN-... e dt.13.12.2021, raporti i oficerëve J V, M M dhe N A me numër dhe datë të njëjtë, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve me e lëshuar në emër të V.Sh.te dt. 13.12.2021, foto albumi i vendit të ngjarjes, foto albumin e substancave narkotike, raporti mbi ekzaminimin e telefonave se bashku me raportin e ekspertimit me nr. AKF-....-.... dt.09.03.2021, raportin e ekspertimit lidhur me ekzaminimin daktiloskopik me nr. AKF/....-.../...-..., raportin e ekzaminimit e substancës narkotike me nr.AKF/...-.../...-... dt.22.02.2022, si dhe shkresat tjera të lëndës, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga te pandehurit.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurve V.Sh.dhe A.H.qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale të kryer në bashkëkryerje blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.1, lidhur me nenin 31, të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurve dhe të njëjtit janë penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë së pandehurit ishin të vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e kanë kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së.

Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurit, secilin veç e veç, gjykata mori pranimin e fajësisë, shprehjen e pendimit për veprën e kryer, premtimin se ne te ardhmen nuk do te kryejnë vepra tjera penale, faktin se ne shkresat e lëndës nuk kishte prova se të njëjtit me parë, kanë qenë te dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Ndërsa rrethana rënduese për të pandehurit gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve. Kryetari i trupit gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 100 (njëqind) euro, për secilin të pandehur, duke u bazuar ne shpenzimet qe janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.2, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 267 par.5 të KPRK-së është konfiskuar substancën narkotike të llojit marihuanë në sasi prej 474.68 gr.

Konform nenit 115 par 2 nenpar 2.1 dhe 2.2 te KPRK-së, nga te pandehurit janë konfiskuar,nga i pandehuri V.Sh., Telefonat S.A.A., modeli SM-A.... me IMEI .... dhe IMEI:..... të cilët telefona pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi duhet të shkatërrohen, pasi qe gjykata vlerëson se nëse te njëjtit do te shiten, telefonat mund te përmbajnë ndonjë te dhënë sensitive private, te të pandehurve apo ndonjë personi tjetër.

Po ashtu konfiskohet Vetura e markës O.A, ngjyrë e kaltër, me targa ..., se bashku me librezën e qarkullimit me nr ..... dhe çelësin e veturës, e cila veturë pas plotfuqishmërie se këtij aktgjykimi duhet te shitet, dhe parat e fituar nga shitja e kësaj veture duhet te derdhën me buxhetin e Republikës së Kosovës, pasi qe gjykata vlerësoj se automjeti ka shërbyer si mjet në kryerjen e veprës penale.

Nga i pandehuri A.H.të konfiskohen: Një telefon I-phone X, ngjyrë e bardhë, me nr. Serik ....., i cili telefon pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi duhet te shkatërrohet, pasi qe gjykata vlerëson se nëse i njëjti do te shitet, telefoni mund te përmbaj ndonjë te dhënë sensitive private, te të pandehurve apo ndonjë personi tjetër. Dhe kartëmonedhat: *Një Kartëmonedhë 1 x 50,00 Euro me nr. serik RD.....; Një Kartëmonedhë 1 x 50,00 Euro me nr. serik UB.....; Një Kartëmonedhë 1 x 20,00 Euro me nr. serik XA.....; Një Kartëmonedhë 1 x 20,00 Euro me nr. serik SE.....; Një Kartëmonedhë 1 x 10,00 Euro me nr. serik TA.....; Një Kartëmonedhë 1 x 10,00 Euro me nr. serik YA.....; Një Kartëmonedhë 1 x 10,00 Euro me nr. serik PA.....; një Kartëmonedhë 1 x 5,00 Euro me nr. serik NB.....; 9 x 2,00 Euro, monedha të metalta; 13 x 1,00 Euro, monedha të metalta; 2 x 0,20 Euro cent, monedha të metalta; 2 x 0,10 Euro cent, monedha të metalta; 1 x 0,05 Euro cent, monedha të metalta; Me shumë të përgjithshme:206,65 Euro, e të cilat para pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi duhet te derdhen ne buxhetin e Republikës së Kosovës, pasi qe gjykata vlerësoj se këto parë janë dobi pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale.*

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda  
PKR.nr.94/22 dt. 17.06.2022.**

**Sekretare juridike**  
Fitore Bojku

**Kryetari i trupit gjykues**  
Shaqë Curri

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.